



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2010/2011

TESTI 1

GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testi të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për punë janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkosh pjesët e përgjigjes, të shkruash diçka etj.

Gjithnjë përdor emërtimet e plota me rastin e zgjidhjes së detyrave, shkurtesat nuk janë të lejueshme (psh., duhet të shkruash: rrethanori i vendit, e jo rr.v.).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.

Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.


Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se që e dorëzon testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaj me stilolaps.

Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

Të dëshirojmë sukses në provim!



1. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

Amfiteatri “Flavio” ose i njohur ndryshe si Koloseu, është ikona e perandorisë romake, i ndërtuar në qendër të qytetit të Romës. Struktura origjinale e tij ka një kapacitet prej rreth 45000-50000 vendesh. Koloseu u shfrytëzua për përleshjet e gladiatorëve në sy të publikut. Amfiteatri, si ndërtesë më e madhe në gjithë historinë e perandorisë romake, u përfundua në vitin ’80 nën udhëheqjen e perandorit Titus, ndërkohë që u modifikua gjatë sundimit të Domitianit. Koloseu u shfrytëzua gjatë rreth një gjysmë mijëvjeçari për gara të ndryshme e luftime gladiatorësh.

Teksti është i shkruar me:

- a) stilin letrar
- b) stilin administrativ
- c) stilin gazetaresk
- d) stilin shkencor

2. Lexo me vëmendje tekstin e dhënë:

Të enjten më 26 mars doli nga shtypi numri i 3-të i revistës për teatër “Loja”. Ky numër i ri, me 210 faqe dhe 15 rubrika të ndryshme, tematikisht, në një pjesë të konsiderueshme të shkrimeve të tij, në nderim dhe përkujtim të 60 vjetorit të vdekjes, i kushtohet regjisorit, aktorit, dramaturgut dhe poetit francez, Antonin Artaudit.

Shkrimeve të shumta u paraprin editoriali me titull “Dashuria shqiptare e Antonin Artaud-it”, i shkruar nga kryeredaktori Bekim Lumi, në të cilin ai zbulon se, për disa vjet me radhë, gjeniu i teatrit Antonin Artaud ka qenë i dashuruar në aktoren shqiptare Gélica Athanasiou (Eugjeni Thanasi).

Më tutje, ky numër i revistës “Loja”, në rreth 70 faqe, për herë parë në shqip ia jep në plotni lexuesit të saj kryeveprën teorike – eseistike të Antonin Artaud-it. “Teatri dhe ekipi i tij”, e cila, me të drejtë, para se teorizim, konsiderohet si një vizion i hapur, reformues, rebelues dhe revolucionar mbi teatrin dhe misteret e tij të shumta. Përkthimi dhe botimi i këtij libri të Artaud-it në shqip është një ndërmarrje e guximshme, e cila, për shkak të vlerës dhe të përmasave monumentale të vetë kësaj vepre, do të duhej të trajtohej si një ngjarje e veçantë kulturore për mjedisin tonë.

- 1) Kujt i kushtohet ky numër i revistës “Loja”?
- 2) Si mban titullin ky editorial?
- 3) Në kë ishte i dashuruar dramaturgu dhe poeti francez?

3. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm:
1. Grup autorësh: Metodika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1987.
 2. Grillo, Kozma: Fjalor edukimi, Tiranë, 2002,
 3. Libër leximi për klasën e tetë, Prishtinë, 2007.
 4. Rama, B. Gjuha shqipe (libër për mësuesin), Tiranë, 2004

Teksti i mësipërm është:

- a) hyrje
- b) përmbajtje
- c) literaturë

4. Në tekstin që vijon nënvizo dy fjali në të cilat janë shprehur informatat më të rëndësishme lidhur me molekulat.

Për molekulat

Për molekulat mund të thuhet se i paraqesin pjesët më të imëta të mundshme të ndonjë substance të cilat i përmbajnë ende vetitë e asaj substance. Molekula e sheqerit është pjesa më e imët e sheqerit me këto veçori. Siç atomet bashkohen në molekula, molekulat bashkohen në bashkësi të mëdha dhe kështu i ndërtojnë trupat të cilat mund t'i vërejnë shqisat tona. Një kokërr sheqer përbëhet nga një numër i madh i molekulave të sheqerit.

Është interesant të përmendet se akulli, uji dhe avulli i ujit përbëhen nga molekulat plotësisht të njëjta. Dallimi i cili ekziston midis këtyre tri substancave është vetëm mënyra e cila i bashkon molekulat ndërveti. (T. Sençanski, Çudirat e elektricitetit)

5. Lexoni diskutimin e mëposhtëm të tre shokëve: Andit, Aurelit dhe Besmirit dhe përgjigjuni çfarë diskutimi është:

Tema: Sporti i vërtetë

Andi: Të rrëshqasësh me ski, sigurisht që është një sport i bukur. Kurse boksi, unë mendoj se është – kur godasin, kur gjakosen – jo ai nuk quhet sport. Të bësh ski, psh., mbetet gjithnjë në sport, po të gjakosesh me grushta...

Aureli: - Këto thua gjithmonë ti, po ama vetëm ti mendon se boksi nuk është sport, se boksierët nuk janë sportistë. Ti nuk e ke idenë, se nuk sheh qoftë edhe në televizor boks. Ti ende nuk di ç'është ringu, prandaj, meqë s'di gjë, më mirë mos fol fare,

Heshtje...

Besmiri: - Unë qeshë një herë me babanë në një ndeshje boksi, por nuk më tërhoqi fare. Shkuam shumë kohë para ndeshjes dhe na u desh të prisnim gjatë. Kur më në fund filloi ndeshja, të gjithë u ngritën në këmbë dhe filluan të bërtitnin. Kështu, unë nuk pashë asgjë...

Ky diskutim është:

- a) shpjegues,
- b) argumentues
- c) përshkrues

6. Fjalja e dhënë i takon stilit bisedimor, jo formal. Zëvendëso ose plotëso disa fjalë ashtu që fjalja të mund të përdoret edhe në situata formale zyrtare.

Vjosa erdhi me autobusin e kombinatit.

7. Shkruaj korrekt fjalitë e mëposhtme duke marrë parasysh rregullat e drejtshkrimit.

1. këtë vit u mbushën 15 vjet qysh kur në ulqin ka nisur një veprimtari letrare me emrin kalimerja poetike organizuar nga shoqata e art club-it nga ulqini.

2. jemi dy qind vjet më pas kur bajroni botoi këngët e para të kryeveprës së tij ku përmend shqipërinë e shqiptarët.

8. Rretho shkronjën para fjalisë e cila është shkruar sipas rregullave të drejtshkrimit.

a) S'foli për njëme me mua tërë natën.

b) Në detyrën e më të mirë që e kam ba spat parregullsi.

c) Frutat që i morëm nuk kenë me shije.

d) Të gjithë më kërkuan derisa nuk më gjetën se ku isha fshehur.

9. Nëse është theksuar vetia tipike për gjuhën e folur, në vijë pranë saj shkruaj "F", kurse nëse është tipike për gjuhën e shkruar, shkruaj "SH":

a) Realizohet në dialog. _____

b) Është formal (zyrtar). _____

c) Plotësohet me gjeste dhe me mimikë. _____

d) Fjalitë i ka më të gjata dhe më të ndërlikuara. _____

10. Nënvizogabimet drejtshkrimore dhe rishkruaj saktë secilën fjalë:

Kopështi i fëmijëve _____

Libëra të reja _____

Mjedis të mirë _____

Ujra të rëmbyera _____

11. Shëno theksin (‘) në fjalët e poshtëshënuara:

flutur dhe fluturoj

12. Radhit fjalët sipas llojit, sipas shembullit të dhënë te emri.

stadium, mace, i bukur, shkatërroj, kush, dinake, përvetësoj, im

emër

mbiemër

përemër

folje

stadium

13. Në shembujt e mëposhtëm zgjidh fjalën shqipe që i përgjigjet fjalës së huaj të dhënë:

= qëllim

Tendencë = qëndrim

= prirje

= fillestar

Elementar = i lehtë

= i vogël

= dhunoj

Abuzoj: = shpërdoroj

= nënshtroj

14. Gjej bashkëtingëlloret e zëshme nga të pazëshmet:

b,th,dh,q,f,c,ç,x,zh,t,g,gj,sh,k,v,s,f,p,z,d

të pazëshme _____

të zëshme _____

15. Cilat nga fjalët e mëposhtme kanë kuptim të pavarur dhe mund të përdoren si të mëvetësishme:

a) emrat, mbiemrat, foljet, ndajfoljet, numërorët, përemrat

b) parafjalët, lidhëzat, pjesëzat

Rrethoni shkronjën para përgjigjes së saktë:

16. Në shembujt e mëposhtëm janë vargjet njërrrokëshe, dyrrrokëshe dhe katër-rrrokëshe: Rretho shenjën nën të cilën gjenden vargjet njërrrokëshe.

a) shoh,

njoh,

rroj

shkronj...

b) i shum

si lumi...

c) Barku firë

s' kërcen mirë...

17. Vendi dridhej, ay mbeti

Se s'tronditej nga tërrmeti.

Div drangoj i Dragobisë,

Trim tribun i Vegjëlisë.

O Bajram, bajrak i gjallë,

More nam me gjak në ballë,

Te një shpell' e Dragobisë,

Yll i rrall' i burrërisë.

Thon' u shtri e thon' u vrà,

Po ti s'vdiqe, or Baba,

As te shkëmb' i Dragobisë,

As te zëmr' e Djalërisë.

As je vrar' e as po vritesh

Legjendar Ante po rritesh.

Dithiramb i Dragobisë,

Tmerr, panik i mizorisë.

“Shpell e Dragobisë”, Fan Noli

Lexo poezinë e dhënë dhe trego figurën stilistike letrare:

- a) Krahasimi;
- b) Epiteti;
- c) Onomatopea;
- d) Metafore.



18. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm, pastaj përgjigju pyetjeve:

Ato prapë vështruan njëra-tjetrën në sy. Sytë e Dianës shkëlqenin si një dritare kujtimesh, kurse ato të Stelës qenë të menduar, të përshkuar nga kureshtja e jetës që s'ë njihte.

Sa ishte rritur Stela! Jo, jo, ajo s'ishte aspak engjëll dhe, si për të pohuar këtë mendin- të fundit të së motrës, papritur Stela pyeti:

- Po ti Diana ke shëtitur me djem atje?

- Posi

- Po ke dashuruar?

- Eh, si të them...,

Ismail Kadare

Fragment nga romani: "Qyteti pa reklama"

Dallo motivin të cilin e ka paraqitur shkrimtari. Rretho përgjigjen e saktë:

- a) Motivin e njohjes;
- b) Motivin e hidhërimit.
- c) Motivin e vetmisë;
- d) Motivin e miqësisë;

19. Para teje e ke fragmentin e një libri.

Në "Shtëpine e kukullës", pronar legjitim i kukullës, është një bashkëshort, një baba dhe një qytetar shembullor. Në shtëpinë e tij të vogël, me 3 fëmijët dhe gruan, ne shohim strehën e ëmbël familjare, familjen e lumtur të ëndërruar. Zonja Helmer jeton e lumtur, e sigurtë se i ka realizuar me të vërtetë të gjitha ëndërrat për të qenë bashkëshorte dhe nënë ideale, për të pasur një bashkëshort ideal, i cili, në rast nevoje, do të mund të jepte edhe jetën për të shpëtuar nderin e saj.

Teksti i shkruar është:

- a) analizë
- b) shpjegim
- c) përshkrim

20. Lexo me kujdes fragmentin nga romani “Dua” të shkrimtarës Brunilda Zllami dhe përgjigju pyetjeve

Kishim arritur në mes të largësisë nga toka e planetit kur ndien tërheqjen e diçkaje të fuqishme. Ishte e njëjta tërheqje që kishin ndier kur ishin thithur nga vorbulla e zezë. Por tani nuk kishe asnjë rrymë ajri, vetëm një tërheqje e fuqishme që nxori nga përdorimi të gjithë motorët. Koli u mundua të ndryshonte drejtimin, por ajo kishte marrë një drejtim që ishte i pakthyeshem. Riglesi pyeti kompjuterin për qeniet që jetonin në atë planet. Ai nuk iu përgjigj. Në ekran shkruheshin të njëjtat fjalë që shkruheshin në atë gjuhën e pakuptueshme. Pas pak në kompjuter doli pamja e treshes mbretërore dhe e planeve të përbëna. Gjithçka rreth tyre: gjatësia e rrezës së secilit, largësia që kishin nga dielli. Çdo gjë ishte llogaritur me një perfeksion të çuditshëm. Ai ndjeu frikë. Që ky planet kishte qenie inteligjente, kjo nuk kishe asnjë dyshim veçse që nuk shfaqeshin se si mund të ishin. Po shikonte me habi, kur vuri re se edhe Rashela ishte ngritur dhe po shikonte bashkë me të, të dhënat që po shënoheshin me shpejtësi. Pas pak u shfaq sërish pamja e kaltër me shikimin e çuditshëm.

Aty është shkruar se është një planet që nuk i do vizitorët,- dëgjoi nga pas zërin e Rashelës. U kthye.

Nga e di ti. Aty është shkruar në një gjuhë që nuk e dimë as unë dhe as ti, - i tha Riglesi duke u kthyer nga Koli që rrinte larg tyre kur takoheshin. Vajza rrudhi buzët nga inati. Disku ndaloi pa tronditje dhe rrezatimi u largua. Koli hapi derën. Zbritën të tre. Në fillim ishte një errësirë e madhe. Më pas çdo gjë u ndriçua. Parasysh u dolën disa qenie të gjata që iu afruan.

1. Ky fragment është roman:

- a) historik
- b) shoqëror
- c) filozofik
- d) shkencor-fantastik

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

2. Në planin dhe programin e lekturës ke lexuar disa romane të këtij lloji. Thekso titullin dhe autorin e një prej këtyre veprave _____



Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	